



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE ZBATIMIT TË PROJEKTEVE

SPECIFIKIMET TEKNIKE

26.1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane

26.1.1 Volumet e punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e 215 kontenierëve me volum 1.1 m³, brenda zonës së kontraktuar.

Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve dhe sipas hartës bashkëngjitur kësaj kontrate. Te gjithë kontenieret do të sigurohen nga punëdhënësi. Mirëmbajtja dhe siguria e kontenierëve do të kryhet nga punëmarrësi

26.1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në:

a. Zbrazen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 10 m² rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave e depozitimit të tyre në landfillin e Sherishtës.

b. Në çmimin njësi të largimit të mbeturinave urbane përfshihet gjithashtu edhe dezinfektimi në përfundim, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri. Mund të bëhet dezinfektimi ditor, pas zbrazjes së çdo kontenieri, duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

26.1.3 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve

a. Autoriteti kontratues ka përcaktuar në fillim të kësaj kontrate pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kontraktuar ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit .

b. Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontratues

sipas nevojave për përmiresimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontratues.

c. Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës, duke filluar jo më parë se ora 19.00, me qëllim që në orën 7.00 zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

d. Autoritetit kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoba për mospërbushjen e tyre.

26.1.4 Rregulla për tu zbatuar

a. Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër çdo pikë të grumbullimit të mbeturinave .

b. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete sipas parashikimit në Nenin “Gjoba dhe penalitetet”

c. Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambiente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenierëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

d. Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontratues në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontratues.

e. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

f. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

g. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

h. Në qoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me

këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

i. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mosbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

26.1.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 15 m³ dhe kamioncinë për heqjen e inerteve, degëve, oredivave shtëpiake etj, me kapacitet jo më pak se 3.5 ton.
2. Të gjitha mjetet që do përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin “Specifikime teknike”, pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.
3. Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:
 - a. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontratues për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
 - b. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontratues. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
 - c. Automjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
 - d. Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjienik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori i shërbimit merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit. Operatori do të riparojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penaltete sipas Nenit ”Penaltete dhe Gjoba”.
 - e. Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenierëve.

f. Të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve duhet të identifikohen sipas numrit respektiv të pikës, që duhet të jetë lehtësisht i dukshëm për komunitetin. Operatori i shërbimit mund të vendosë dukshëm numrat e pikave mbi njërin nga kontenierët apo ambjentet e tjerë rreth pikës sipas “Listës së pikave dhe vendodhjes së tyre”.

g. Mesazhe për edukimin ambjental.

26.2 Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve

26.2.1 Volumet e punimeve

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë 215 **kontenierë** të volumeve 1.1 m³/, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontratues.

26.2.2 Metodologjia

1. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo natë në autoparkun e tij dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.
2. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë edhe kontenierët e demtuar.
3. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
4. Me shërbim dezinfektimi kuptojmë realizimin shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

26.2.3 Grafikët e punimeve

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit, i cili nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut.
3. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjoka dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

26.2.4 Rregulla për tu zbatuar

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj..

26.3 Mirëmbajtja e pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme.

26.3.1 Volumet e punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve dhe vendosjen e 215 kontenierëve 1.1m³. Shërbimi i mirëmbajtjes gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, do të kryhet në të gjitha pikat e grumbullimit si dhe në gjithë hapësirat publike e territoriale të zonës së kontratuar.

26.3.2 Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme, konsiston në:

a. Mirëmbajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve urbane të hedhura dhe depozituara jashtë kontenierëve, mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme të depozituara në të gjithë zonën e kontraktuar, si dhe të mbetjeve urbane voluminoze (ambalazhe) që tejmbushin artificialisht kontenierët dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për tu depozituar nëpër kontenierë, në mënyrë që të gjitha pikat dhe kontenierët të jenë të pastër në vazhdimësi gjatë gjithë ditës. Nuk ka kufizime në pastrimin e sipërfaqes rreth kontenierit dhe operatori i shërbimit është i detyruar të largojë çdo mbetje urbane në të gjithë zonën e kontraktuar sado larg kontenierit të jetë hedhur.

b. Ky shërbim kryhet me anë të mjetit të vogël dhe të hapur (kamionçina) që qarkullojnë nëpër të gjitha pikat e grumbullimit të zonës së kontraktuar për të mbledhur dhe larguar çdo papastërti që hidhet dhe depozitohet jashtë kontenierëve. Sipas nevojave që mund të ketë çdo pikë mund të jetë e nevojshme pastrimi disa herë në ditë të pikave dhe kontenierëve mbi të cilët në vazhdimësi ndotet gjatë orëve të ndryshme të ditës.

c. Mbas pastrimit kontenierët kthehen në vendqëndrimin e tyre të mëparshëm.

d. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e këtij shërbimi, përgatiten nga sipermarrësi dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenierësh. 2. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse. 3. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërmbushjen e tyre.

g. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbetje urbane, ndërtimore, të vëllimshme dhe sipërfaqe rreth tyre të papastruara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë ora e njoftimit apo konstatimit të problemit.

h. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar dhe deklaruar të të makinerive dhe pajisjeve dhe punëtorë për kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.

i. Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballlet me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

j. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mozbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

26.4 Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë.

26.4.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet,

26.4.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

a. Fshirjen me punëtorë me fshehtë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve, trotuareve dhe rrugëve dytësore, të kategorive duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m nga kuneta.

b. Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.

c. Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.

d. Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.

e. Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar.

26.4.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 24.00-06.00.

b. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontratues mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga sipërmarresja dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

26.4.4 Rregulla për tu zbatuar

a. Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër çdo sipërfaqe rruge dhe trotuari .

b. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të penalizohet sipas parashikimit në nenin "Penalitete dhe Gjoba"

c. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse ,zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrim të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballat me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

d. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

e. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoba për mosplotësim të tyre.

f. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

g. Nën termin papastërti nënkuptohen të gjithë mbeturinat si: rërë, xham, letër, gurë, shishe, materiale organike, etj .

26.4.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

26.5 Fshirja e rrugëve me makineri teknologjike.

26.5.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe gjatësitë lineare për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet.

26.5.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:

a. Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë nga parkimi. Më pas çdo mbeturinë e mbetur nga pastrimi me mjete teknologjike, pastrohet nga punëtorët e shërbimit të fshirjes me krahë..

b. Në të gjitha gjatësitë lineare dhe segmentet e lira nga parkimi, të rrugëve kryesore dhe dytësore, të përcaktuara në volumet e shërbimit të fshirjes me makineri. fshirja detyruesisht duhet kryer me makinë teknologjike. Në rast të kundërt do të konsiderohet i pavlefshëm shërbimi i kryer.

26.5.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 24.00-06.00.

b. Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontratues, me qëllim që në orën 7.00 zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, pergatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.

2. Llojin dhe intenerarin e makinës teknologjike (autofshesë) që do të kryejnë shërbimin.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e makinave teknologjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbytjen e tyre.

26.5.4 Rregulla për tu zbatuar

- a. Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër çdo gjatësi lineare rruge.
- b. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit i shërbimit dhe do të penalizohet
- c. Operatori i shërbimit detyruesisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.
- d. Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.
- e. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes së rrugëve, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.
- f. Nën termin papastërti nënkuptohen të gjithë mbeturinat si: rërë, xham, letër, gurë, shishe, materiale organike, etj

26.5.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të rrugëve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës me kapacitet jo më pak se 5 m³.
- b. Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.

26.6 Larja e rrugëve me makinë teknologjike

26.6.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion për të gjithë zonën e kontraktuar si për shërbimin e parë të larjes gjatë natës. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makinë teknologjike, si shërbim një herë në ditë gjatë natës, parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet

26.6.2 Specifikimet teknike dhe metodologjia

Shërbimi i larjes me presion, me makineri teknologjike konsiston në:

1. Larjen me presion me makineri teknologjike larëse me kapacitet jo më pak se 17 m³, si shërbim një herë në ditë, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve të parashikuara, në mënyrë që makina larëse të mbulojë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

2. Ky shërbim do të kryehet gjatë 4 muajve të vitit.

26.6.3 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

1. Larja e rrugëve, si shërbim një herë në ditë, do të bëhet çdo ditë, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 05.00-07.00.

2. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të larjes së rrugëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.

3. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

a. Oraret e operimit në secilën rrugë.

b. Llojin dhe itinerarin e makinë teknologjike (autobot) që do të kryejnë shërbimin.

Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

4. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

26.6.4 Rregulla për tu zbatuar

1. Autoriteti kontratues ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për larje si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për larjen e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në larje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i larjes do të konsiderohet i pavlefshëm.

26.6.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve, këto mjete dhe pajisje:

a. Makinë teknologjike larëse (autobot) me kapacitet jo më pak se 17 m³, si shërbim një herë në ditë, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve të parashikuara, në mënyrë që makina larëse të mbulojë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.